



RIINVEST

BPrAL KOLEGJI RIINVEST SH.A.

RREGULLORE PËR MASAT DISIPLINORE DHE PROCEDURAT

Shkurt 2019

Në pajtim me kompetencat e dhëna në Ligjin për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037), Ligjin për Shoqëritë Tregtare në Republikën e Kosovës (Nr. 06/L-016) dhe Statutin e BPrAL Riinvest, e në pajtim me Ligjin e Punës (Nr. 03/L-212), Bordi Drejtues i BPrAL Riinvest miratoi këtë ***Rregullore për Masat Disiplinore dhe Procedurat***.

Neni 1 – Qëllimi i Rregullores

1.1 Qëllimi i rregullores për masa disiplinore është vendosja standardeve të respektimit të parimit të barabarësisë, dhe të së drejtës brenda kolegjit Riinvest. Kjo rregullore inkurajon punonjësit dhe anëtarët tjerë të Kolegjit të respektojnë standarde të sjelljes së mirë, etike, profesionale dhe jo diskriminuese, mosndërmarrja e së cilave mund të rezultojë me zhvillimin e masave disiplinore ndaj tyre.

1.2 Kjo rregullore nuk përbën heqje dorë për ndërmarrjen e veprimeve tjera ligjore nga ana e Kolegjit për të realizuar të drejtat e veta kundrejt të gjithë akterëve të brendshëm të tij, në rast të shkeljeve të evidentuara nga lëmi i marrëdhënies së punës, marrëdhënieve detyrimore apo në kuptim të obligimeve të mësimdhënies dhe mësimnxënies.

PJESA I – SHKELJET DISIPLINORE

Neni 2 - Shkeljet disiplinore

Në pajtim me këtë Rregullore, shkeljet e saj ndahen në shkelje të lehta disiplinore dhe shkelje të rënda disiplinore.

Neni 3 – Shkeljet e lehta disiplinore

3.1 Shkelje e lehtë disiplinore konsiderohen rastet në vijim: mungesa e paarsyeshme në punë, gabimet e vogla të pakujdesshme ose gabimet e përsëritura që nuk do të jenë temë që të formojnë procedura disiplinore, do të merren si shkelje e lehtë disiplinore.

3.2 Komisioni disiplinor do të mbledhë dhe shqyrtojë çdo dokument ose evidencë që ka lidhje me rastin, do të marrë në pyetje shkelësin e supozuar, deklaratën e tij, personin që ka paraqitur rastin e supozuar dhe secilin që ka informata në lidhje me rastin. Intervistimi duhet të mbahet

sa më shpejt që është e mundur, brenda 3 ditëve të punës pas paraqitjes së rastit me qëllim të përcaktimit se a është bërë shkelje e lehtë apo ka dëshmi se është kryer shkelje e rëndë.

3.3 Nëse Komisioni disiplinor konstaton se është bërë shkelje e lehtë dhe është hera e parë, atëherë shkelësit i jepet paralajmërim verbal, kurse për shkelje të përsëritur pason paralajmërim me shkrim dhe atë jo më larg se 3 ditë pune pas intervistës. Procesverbali i paralajmërimit me gojë dhe me shkrim duhet të vendoset në dosjen personale të shkelësit.

Neni 4 – Shkeljet e rënda disiplinore

4.1 Shkelje e rëndë disiplinore janë rastet kur udhëheqësi i njësisë përkatëse konstaton se është kryer shkelje e rëndë e detyrave dhe obligimeve të anëtarit. Në raste të tilla, ai/ajo do të paraqesë rastin te Komisioni disiplinor i Kolegjit. Komisioni disiplinor do të intervistojë shkelësin e supozuar brenda 5 ditësh prej momentit që është referuar te Komisioni Disiplinor me qëllim që të sqarohet natyra e shkeljes së supozuar dhe vërtetuar se shkelja duhet të trajtohet si shkelje e rëndë e kësaj Rregulloreje, akteve tjera normative të Kolegjit apo e kontratës mes Kolegjit dhe palës.

4.2 Komisioni do të vendosë për datën dhe vendin e mbajtjes së seancës së Komisionit. Seanca e Komisionit do të mbahet brenda 14 ditësh nga data e intervistës, ndërsa në të pala që pretendohet që ka kryer shkelje disiplinore mund të shoqërohet nga një person tjetër.

4.3 Në raste kur ka dëshmi të dhunës ndaj njerëzve të tjerë ose rrezik ndaj pronës, udhëheqësi i njësisë përkatëse mund të vendosë që ta suspendojë (pezullojë) shkelësin e supozuar nga puna dhe atë me pagesë për kohën derisa hetimet dhe procedura disiplinore të jenë duke u zhvilluar.

4.4 Shkelje të rënda konsiderohen, mes tjerash, rastet në vijim:

- a. Kundërshtimi i paarsyeshëm për kryerjen e detyrave të përcaktuara në kontratën e punës;
- b. Vjedhja, mashtrimi, falsifikimi, dëmtimi ose shfrytëzimi i paautorizuar i pasurisë së Kolegjit;
- c. Prishja e Kodit të Mirësjelljes në Kolegjin Riinvest;
- d. Mungesa e paarsyeshme në punë më shumë se 5 ditë radhazi pa asnjë arsye dhe pa e lajmëruar mungesën;

- e. Gabimet e përsëritura të cilat me shpeshësinë dhe peshën e tyre e çrregullojnë ecurinë normale të punës;
- f. Diskriminimi ose keqtrajtimi i drejtpërdrejtë ose i jo i drejtpërdrejtë, kundër personit tjetër të Kolegjit, në bazë të gjinisë, racës, ngjyrës, gjuhës, religjionit, banimit, mendimeve politike, origjinës sociale dhe rasteve të tjera të mbrojtura me ligj;
- g. Abuzimet për qëllime të ulëta morale, shkelja e dinjitetit të personit në punë që është e padëshirueshme ose fyese e cila krijon armiqësi, duke kërcënuar ose frikësuar atë person;
- h. Sjellja e papranueshme jashtë vendit të punës që nuk përkon me rregulloret e personelit ose studentit në Kolegji, dhe e cila mund ta diskreditojë Kolegjin.
- i. Dëmtimi i pronës me paramendim;
- j. Mos ruajtja e sekreteve zyrtare-profesionale;
- k. Paaftësi serioze gjatë punës e shkaktuar nga alkooli ose droga;
- l. Dhënia e deklaratës së pavërtetë në lidhje me konfliktin e interesit.
- m. Sjellje agresive, kërcënuese ose fyese në vendin e punës, dhe shkelje të ngjashme të parapara me ligj dhe akte të tjera të Kolegjit.
- n. Çdo shkelje tjetër e rëndë e cila me arsye mund të konsiderohet se ka dëmtuar pronën fizike apo intelektuale të Kolegjit, reputacionin e tij apo t'i ketë shkaktuar dëm çfarëdo pale të tretë me të cilën Kolegji ka marrëdhënie juridike apo faktike.

PJESA 2 – PROCEDURA DISIPLINORE

Neni 5 - Zgjidhja e konflikteve me marrëveshje

Kolegji Riinvest angazhohet që t'i zgjidhë me marrëveshje e mirëkuptim të gjitha konfliktet që mund të paraqiten gjatë zhvillimit të veprimtarisë së vet.

Neni 6 - Komisioni disiplinor

6.1 Rektorja në cilësinë e udhëheqëses ekzekutive dhe me propozimin e Këshillit Akademik do të formojë një Komision disiplinor, i cili do t'i shqyrtojë rastet që kanë të bëjnë me shkeljet serioze të supozuara dhe pas zhvillimit të procedurës së paraparë me këtë rregullore dhe Statut, i propozon organin përkatës marrjen e masës disiplinore. Komisioni do të përbëhet nga tre anëtare të përhershëm.

6.2 Mandati i anëtarëve të Komisionit disiplinor do të zgjasë aq sa zgjat edhe mandati i organit, i cili e ka emëruar këtë komision. Në rastet e konfliktit të interesit kur objektiviteti i anëtarit do të vihet në dyshim, anëtari i komisionit do të zëvendësohet dhe do të caktohet një zëvendës për atë seancë të veçantë dhe atë në rastet:

- ku anëtari i komisionit është në pozitë të udhëheqësit ndaj shkelësit të supozuar;
- ku ai/ajo ka lidhje me shkelësin nga ana familjare;
- ku anëtari i komisionit ka qenë viktimë e shkelësit të supozuar ose ka lidhje me viktimën nga ana familjare.

Neni 7 – Puna e Komisionit Disiplinor

7.1 Shërbimi profesional i Kolegjit, i njësive akademike dhe i njësive të tjera organizative, do t'i ofrojë Komisionit disiplinor:

- sigurimin e këshillave dhe udhëzimeve për anëtarët e komisionit,
- grumbullimin e dëshmive të dokumentuara,
- përgatitjen e orarit të seancave,
- njoftimin e personave që kërkohet të jenë prezentë për detajet e vendtakimit, datën dhe kohën e seancës,
- mbajtjen e procesverbalit për seancën disiplinore dhe vendosja e tij në dosjen e kandidatit, dhe çështje të tjera që kërkohen për zhvillimin e procedurës.

7.2 Seanca disiplinore duhet të mbahet sa më shpejt që është e mundur dhe në çdo rast jo më vonë se 14 ditë nga data e intervistimit fillestar. Qëllimi i seancës është t'i vërtetojë faktet. Vendimi duhet t'i komunikohet shkelësit brenda 5 ditësh nga data e marrjes së vendimit. Procesverbali dhe vendimi i Komisionit duhet të vendosen në dosjen e personit.

7.3 Komisioni disiplinor do t'i dëgjojë dëshmitë; do të përcaktojë, në bazë të evidencës, nëse shkelja është kryer; do të propozojë masën disiplinore.

7.4 Komisioni Disiplinor do të merr vendim mbi rastin e paraqitur jo më vonë se 30 ditë kalendarike nga data e paraqitjes së tij.

Neni 8 Paraqitja dhe identifikimi i shkeljes disiplinore

8.1 Çdo shkelje e dyshuar ose e supozuar duhet të paraqitet tek udhëheqësi i njësisë organizative të Kolegjit, respektivisht të departamentit ose administratës (në tekstin e mëtejme: tek udhëheqësi i departamentit përkatës).

8.2 Udhëheqësi i departamentit përkatës, menjëherë pas pranimit të raportit me gojë apo me shkrim për shkelje të supozuar disiplinore, duhet që në afat prej tri ditëve t’ia paraqesë rastin Komisionit disiplinor, të intervistojë shkelësin e supozuar dhe personin që ka raportuar, t’i analizojë detajet e dhëna në deklaratë, dhe sipas vlerësimit së tij do të vendosë për klasifikimin fillestar të shkeljes si shkelje e natyrës së lehtë apo të rëndë.

8.3 Në marrjen e vendimit, udhëheqësi i njësisë përkatëse do të mbështetet në dispozitat e kësaj Rregulloreje, akteve tjera normative të Kolegjit, dhe ligjeve të zbatueshme në Republikën e Kosovës.

PJESA III – MASAT DISIPLINORE

Neni 9 - Masat për shkeljet e rënda disiplinore

9.1 Komisioni disiplinor pas shqyrtimit të hollësishëm të rastit, i propozon organit përkatës që t’i aplikojë këto masa:

- vërejtje me shkrim, të cilën e shqipton udhëheqësi i departamentit apo sekretarja e përgjithshme, vërejtja e fundit të cilën e shqipton kryetari/ja i/e këshillit akademik, rektori/ja.
- ndalim i pagesës nga 10% deri në 50%, të cilën e shqipton kryetari i këshillit akademik, rektori/ja.
- ndalim i rritjes së pagës deri në një vit, të cilën e shqipton Bordi Drejtues.
- mos ngritje e pozitës deri në 3 vjet, të cilën e shqipton këshilli akademik, rektori/ja.
- ulja e pozitës, të cilën e shqipton Bordi Drejtues dhe
- ndërprerja e marrëdhënies së punës, të cilën e shqipton Bordi Drejtues.

Neni 10 - Procedura e ankesave

Procedura e ankesave ka për qëllim që të mbrojë palët e procedurës nga vendimet e padrejta. Pala e pakënaqur me vendimin, me të cilin i është shqiptuar masa disiplinore ka të drejtë ankese pranë Këshillit Akademik (në rast të shkeljeve të lehta) dhe pranë Bordit Drejtues (në rast të shkeljeve më të rënda). Punonjësi pakënaqur nga vendimi i Këshillit Akademik, përkatësisht i Bordit Drejtues, ka të drejtë në mbrojtje të mëtejshme gjyqësore sipas legjislacionit të punës.

Neni 11 - Emërimi i Komisionit të ankesave

11.1 Këshilli Akademik ose Bordi (në tekstin e mëtejshëm organi përkatës), do të emërojë një Komision të ankesave. Komisioni do të përbëhet nga tre anëtarë të përherëshëm nga radha e anëtarëve të organit përkatës. Mandati i anëtarëve të Komisionit për ankese do të zgjasë aq sa zgjat edhe mandati i organit i cili e ka emëruar këtë komision. Anëtarët e komisionit të ankesave nuk mund të jenë edhe anëtarë të Komisionit disiplinor.

11.2 Në rast të konfliktit të interesit, anëtari i Komisionit të ankesave tërhiqet dhe zëvendësohet për atë seancë të veçantë, nëse:

- është në raport menaxhimi drejtues me ankuesin ose është i afërm me të nga ana familjare,
- ka lidhje familjare me shkelësin,
- është i implikuar në incident (ngjarje) që është temë e ankesës.

11.3 Paraqitësi i ankesës duhet të paraqesë fakte, argumente dhe prova të reja duke përmbledhur shkurtimisht arsyet për ankese. Seanca për shqyrtimin e ankesave duhet të mbahet sa më shpejt që është e mundur dhe për çdo rast jo më vonë se 30 ditë nga dita kur ankesa i është drejtuar Komisionit të ankesave.

11.4 Komisioni i ankesave do të rishqyrtojë dëshminë, përcaktojë në bazë të dëshmive se a duhet të pranohet ankesa, dhe përshkruajë masën disiplinore që duhet të zbatohet.

11.5 Komisioni i Ankesave mund të kërkojë prezencën e dëshmitarëve për të dëshmuar për rastin. Qëllimi i Komisionit të Ankesave është që të marrë parasysh dëshminë në ankese, duke marrë dëshmi shtesë në gjetjen e fakteve të bazuara. Seanca e dëgjimit duhet të kompletohet sa

më shpejt që të jetë e mundur dhe komisioni duhet të vendosë brenda 15 ditëve prej ditës ku rasti i është paraqitur komisionit. Komisioni vendos me shumicën e votave të anëtarëve.

11.6 Organi përkatës në bazë të propozimit të Komisionit merr vendim, i cili i kumtohet ankuesit brenda 5 ditëve nga dita e marrjes. Procesverbali i Komisionit të ankesave duhet të vendoset në dosjen e ankuesit.

Neni 12 – Dispozitat përfundimtare

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Bordi Drejtues dhe nënshkrimit nga Kryesuesi i Bordit Drejtues.

Prishtinë,

14 shkurt 2019

Rasim Mrlaku, Kryesues